

Detyrat funksionale te kryetarit te ASHDME

Agjencia drejtohet nga Kryetari i Agjencisë, marrëdhëniet e punës të të cilit, rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil. Kryetari është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Agjencisë dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me autoritetet shtetërore përgjegjëse dhe me të tretët. Kryetari i Agjencisë kryen detyrat si më poshtë:

- a) drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë financiare dhe buxhetore të institucionit menaxhon aktivitetin e përgjithshëm lidhur me ofrimin e shërbimeve;
- b) planifikon, drejton dhe koordinon funksionimin e përgjithshëm të Agjencisë;
- c) ka përgjegjësi të plotë menaxheriale për veprimtarinë e njësive brenda Agjencisë;
- ç) shpërndan punën dhe siguron arritjen e rezultateve në kohë dhe me cilësi, sipas objektivave të planifikuara;
- d) ndjek dhe koordinon procesin e zbatimit të politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet sektorëve që ka në varësi;
- dh) identifikon mundësitë për reduktim të shpenzimeve, me qëllim përmirësimin e politikave, dhe performancës së Agjencisë;
- e) miraton përshkrimet e punës të punonjësve të Agjencisë;
- ë) bashkërendon veprimtarinë me institucionet e tjera që kanë detyrim në fushën që mbulon Agjencia, ndjek dhe raporton për detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e nënshkruara ku është palë Agjencia;
- f) bashkërendon punën me institucionet monitoruese me qëllim që konkluzionet dhe rekomandimet e monitorimit të përfshihen në programet dhe politikat që ndjek institucioni.